



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
KËSHILLI I BASHKISË



PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE TË
BASHKISË DROPULL PËR VITIN 2020.

Ne mbështetje të nenit 8, pika 2, nënparagrafi 1, shkronja "b", nenit 35 pika 1 dhe nenit 54 shkronja "f" të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Per Veteqeverisjen vendore ; Ligjin nr . 9632 dt.30.10.2006, "Per Sistemin e Taksave Vendore (i ndryshuar); VKM Nr.132, datë 7.3.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës" Ligjin nr.9920 dt.19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise"(i ndryshuar); Ligji nr 10279 date 20.5.2010"Per kundravajtjet administrative"; VKM nr.632, date 11.06.2009"Per miratimine tarifave te perdorimit te kullotave dhe livadheve per kullotje dhe kositje", VKM nr.1064, date 22.12.2010"Per disa ndryshime ne Vendimin nr.391, date 21.6.2006 te Keshillit te Ministrave "Per percaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe te kullotave"; te ligjit 9693"Per fondin kullusor", Ligjin 10119 ,date 23.4.2009"Per planifikimin e territorit "(I ndryshuar) ;VKM nr 54. Date 05.2.2014"Per percaktimin e kriterëve,procedures dhe menyres se dhenies me qira ,enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore"(I ndryshuar);Vendimi Nr.1096 date 28.12.2015"Per miratimin e rregullave ,kushteve e procedurave per perdorimin dhe menaxhimin e hapesires publike" VKM nr .970 date 02.12.2015"Per percaktimin e procedurave dhe kushteve per dhenien e licensave dhe tregtimin e naftes bruto dhe nenprodukteve te saj"(I ndryshuar) Udhezimit te Ministrise se Transportit dhe Infrastruktures nr .5627date 18.11.2016"Per percaktimin e kriterëve,rregullave dhe dokumentacionit per leshimin e licensave dhe certifikatave per ushtrimin e veprimtarise ne transportin rugor te udhetareve brenda vendit", VKM .nr 285 date 27.06.2002" Tarifa e sherbimeve qe kryen Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit, ndaj shtetasve dhe personave juridik e fizike ,vendas e te huaj", Keshilli i Bashkise ne mbledhjen e dates 20/11/2019 me propozim të Kryetarit të Bashkisë

V E N D O S I :

Te miratojë nivelet treguese per taksat dhe tarifate vendore per vitin 2020 si me poshte :

I.TAKSAT VENDORE

Lloji, baza tatimore, kategorizimet, kestet e pagimit, koha e kryerjes, kushtet lehtësuese.

I.1. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel

Çdo subjekt, i cili kryen nje biznes, me ane te te cilit realizohet gjate vitit fiskal qarkullim me i vogel ose i barabarte me 8000000 leke, i nenshtrohet detyrimit te pageses se tatimit te thjeshtuar mbe fitimin per biznesin e vogel.

Baza e takses/tatimi:kestet e parapagimit te tatimit te thjeshtuar mbi fitimin,per vitin vijues,per tatim paguesit me qarkullim vjetor nga 5(pese) deri ne 8(tete) milione leke llogariten ne baze te te dhenavete deklarates tatimor te nje viti me pare Nivelet e Tatimit te thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel

Shkalla tatimore

Per tatimpagues me qarkullim vjetor nga 0 deri ne 5.000.000leke eshte 0(zero) lek/vit

Per tatimpagues me qarkullim vjetor nga 5.000.000 deri ne 8.000.000leke eshte 5% e fitimit lek/vit

Menyra e pageses:

Tatimpaguesi parapaguan me keste tremujore ,kesti i pare brenda dates 20Prill,Kesti i dyte brenda dates 20Korrik,kesti i trete brenda dates 20Tetor dhe kesti katert brenda dates 20 Dhjetor.

Struktura pergjegjese per vjeljen e takses/tatimit

Drejtoria Rajonale Tatimore eshte pergjegjse per vjeljen e kesaj takes dhe ne rolin e Agjentit Tatimor perfiton nje komision prej 1%te te ardhurave te grumbulluara.

I.2.Taksa mbi pasurine e paluajtshme

Taksas mbi pasurine e paluajtshme i nenshtrohen te gjithë personat fizike ose juridik,vendas ose te huaj,pronare,apo perdorues te pasurive te mesiperme ,ne territorin e Republikes se Shqiperise pavarasisht nga niveli i shfrytezimit te ketyre pasurive.Bejne perjashtim rastet kur ne ligj parashikohet ndryshe.Detyrimin per taksen e kane sipas rastit ,pronari,bashkepronari ,sipas pjeses qe zoteron ,apo perdoruesi i pasurise se paluajtshme,per pasurite qe nuk jane pajisura me dokumanta pronesie.

Dokumenta qe vertetojne pronesine jane:Çertifikata e Pronesise,Vendimi i Komisionit te Kthimit te Pronave,Vendimi i Privatizimit,dokumenta te tjera konform legjislacionit ne fuqi.Ne rast te mungeses se dokumentacionit te pronesise perdoruesi i ndertesës ben nje vetdeklarim te siperfaqes se ndertesës,prane bashkise ku ndodhet ndertesës.

Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme ndërtesës llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit.

Ne taksat mbi pasurine e paluajtshme perfshihen:

-taksa mbi ndertesat

-taksa mbi token bujqesore

-taksa mbi truallin

Ne rast te mungese se dokumentacionit te pronesi(ndertesës,tok bujqesore, truall),perdoruesi i pasurise ben nje vetdeklarim te siperfaqes prane bashkise.Bashkia nepermjet komisionit te ngritur mund te vleresoje siperfaqen e taksueshme.

TAKSA MBI NDERTESAT

Taksas mbi ndertesën i nenshtrohen te gjithë personat fizike ose juridik,vendas ose te huaj,pronare,apo perdorues te pasurive te mesiperme ,ne territorin e Republikes se Shqiperise pavarasisht nga niveli i shfrytezimit te ketyre pasurive.

I nenshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin,urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve paleje”.

I nenshtrohen zhvilluesit të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Detyrimi per taksen mbi ndertesat llogaritet si shumezim i bazes se takses me shkallen e takses mbi ndertesat.

Baza e takses:eshte vlere e ndertesës,qe llogaritet ne perputhje me metodologjine dhe procedurat e pracktuara me vendim te Keshillit te Ministrave.

Vlera e pasurise llogaritet si shumezim I çmimit per m2 me siperfaqen e ndertesës njesi pronesore.

Dallojme ndertesës qe sherbejne per banim dhe ndertesës qe nuk sherbejne per banim.

Cmimi mesatar referues te ndertesave per banim dhe per ndertesës qe nuk sherbejne per banim.

Percaktuar ne aneksin 1 aneksin 2 teVKM Nr.132, datë 7.3.2018

Ky çmim per ndertesat banim sipas aneksit 1 eshte 27000lek/m2

te reduktohet ne masen minus 25% ,pra te jete 20250lek/m2

Per ndertesa qe nuk shërbejnë per banim

a-Per veprimtari tregtimi dhe sherbimi

Çmimi per meter katror sipërfaqe ndertimi eshte 1.5 here me i larte se çmimi i sipërfaqes se banimit
Ky çmim eshte 30375lek/m²

b-Parkim i mbuluar dhe bodrume

Çmimi per meter katror sipërfaqe ndertimi eshte 70% e çmimit te sipërfaqes se banimit
Ky çmim eshte 14175lek/m²

c-Parkim i hapur

Çmimi per meter katror sipërfaqe ndertimi eshte 30% e çmimit te sipërfaqes se banimit
Ky çmim eshte 6075lek/m²

c-Per veprimtare industriale

Çmimi per meter katror sipërfaqe ndertimi eshte 50% e çmimit te sipërfaqes se banimit
Ky çmim eshte 10125lek/m²

d- Per veprimtari bujqesore-blektorale

Çmimi per meter katror sipërfaqe ndertimi eshte 30% e çmimit te sipërfaqes se banimit
Ky çmim eshte 6075lek/m²

Shkalla e taksës

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës,

Te jete si më poshtë:

a) për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim

nga 0,05% te kete ulje 10% duke aplikuar ne masen 0.045%

b) për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike

Shkalla e taksës nga 0,2% te kete rritje +30% duke aplikuar ne masen 0.26%

c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Ndertesa banimi qe shfrytezohen per banim/strehim:

Nenkupton ndertesa e cila u sherben njerezve per nevoja themelore duke perfshire shtepite,apartament,banesa dhe ndertesat e ngjashme.

Garazhet-bodrumet –çdo ndertese tjeter e ngjashme ,mbi apo nen toke ,qe nuk perdoret apo shfrytezohet per qellime te tjera veç atij te banimit.

Ndertesa banimi ndertuar para 1993 dhe pas 1993

-ndertesa me dokument pronesie

-ndertesa qe identifikohet ekzistence por nuk arrihet te percaktohet sipërfaqja .

Per keto ndertesa perdoret vlere referuese per sipërfaqe 100m²sipërfaqe per ndertesa banimi pas 1993 dhe 70m² per sipërfaqe per ndertesa banimi para 1993

Ndertesa per veprimtare tregtimi dhe sherbimi

Ne kete kategori do te perfshihen edhe ndertesa tregtare , ku njekohesisht realizohen edhe procese te perziera prodhim,tregtim dhe shitje me pakice,hotele,njesi shitjeje,pika karburanti,farmaci klinika,njesi sherbimi,etj te ngjashme me to).

Ndertesa per veprimtare industriale.

Ne kete kategori do te perfshihen te gjitha ndertesat te destinuar per veprimtare industriale si prodhim, perpunim ose magazinim te mallrave industrialeduke perfshire fabrikat ,depot,magazinat dhe objekte te tjera te ngjashme

- Per veprimtari bujqesore-blektorale

Ne kete kategori do te perfshihen te gjitha ndertesat qe perdoren per bujqesi dhe blektori apo veprimtari mbeshketese,si grumbullim ,magazinim dhe ruajtje te produkteve bujqesore dhe blektorale perjashtuar perpunimin.

Menyra e pageses:

Per kategorine "Ndertesat banimi"

detyrimi do te paguhet brenda vitit dhe pagesa me keste,kesti I deri ne 20Prill,kesti II deri ne 20 Korrik,kesti III deri 20Shtator dhe kesti IV deri ne 20Dhjetor.

Kjo takse do te arketohet nga Agjenti tatimor i perzgjedhur nga Kryetari I Bashkise ,marredheniet me te cilin rregullohen me kontrate te posacme .

Per kategorine ndertesat qe nuk sherbejne per banim

detyrimi do te paguhet me 2 keste.

Kesti I pare paguhet brenda dates 20Prill

Kesti I dyte paguhet Brenda dates 30Qershor

Struktura e ngarkuar per te ndjekur ,llogaritur dhe vjeljen e takses mbi ndertesat, eshte Drejtoria e te Ardhurave.

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

- a) pronat e shtetit dhe të njëjve të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- e) strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";
- ë) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;
- f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse

b-Taksa per Token bujqesore

Baza e takses mbi token bujqesore:eshte siperfaqja e tokes bujqesore,ne hektar , ne pronesi ne perdorim te takspaguesit. Siperfaqja e tokes ne pronesi percaktohet sipas dokumentave qe e vertetojne ate(certificate pronesia,akt I merrjes se tokes ne pronesi)

Niveli I takses caktohet ne leke per hektar .Detyrimi I takses llogaritet si shumezim I nivelit te takses me bazen e tatueshme.

Niveli I takses mbi token bujqesoreparaqitet si me poshte;

a) Kategoria e I	2800leke /ha ne vit
b) Kategoria e II	2100 leke /ha ne vit
c) Kategoria e III	1400 leke/ha ne vit
d) Kategoria e IV	1350 leke/ha ne vit
dh)Kategoria e V	1250 leke/ha ne vit
e)Kategoria e VI	1200 leke/ha ne vit
f)Kategoria e VII	1100 leke/ha ne vit

Klasifikimi sipas kategorive te tokes bujqesore behet nga strukturat e Ministrise se Bujqesise.

Detyrimi per pagese

Taksa mbi token bujqesore eshte nje detyrim vjetor,ku afati I fundit per likujdimin e saj eshte data 31Dhjetor.- Kjo takes do te shlyhet ne kater keste.Kesti i i pare brenda dates 20Prill,Kesti i dyte brenda dates 20Korrik,kesti i trete brenda dates 20Tetor dhe kesti I katert brenda dates 31 Dhjetor.

Struktura e ngarkuar per ndjekjen e kesaj takes eshte Drejtoria e te Ardhurave dhe Agjent tatimor sipas kontrates.

Perjashtime:

-Perjashtohen nga taksa tokat bujqesore qe mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari per pese vitet e para nga casti i mbjelljes.

-Perjashtohen nga kjo takse personat nen minimumin jetik.

c-Taksa e truallit

Bazae takses mbi truallin eshte siperfaqja e truallit ne m²,ne pronesi apo perdorim te takspaguesit.

Niveli I takses :caktohet ne lek per meter katror.Detyrimi I takses llogaritet si shumezim I nivelit te takses me bazen e tatueshme.Nivelet treguese te takses,per cdo kategori minimale te bazes se takses jane si me poshte:

0,14lek/m²/vit per qellime banimi nga individet

12leke/m²/vit per qellime biznesi.

Agjenti tatimor per vjeljen e kesaj takese per familjaret,per biznesin Drejtoria e te Ardhurave.

3-Taksa e fjetjes ne hotel

Baza e takses se fjetjes ne hotel eshte numri i neteve te qendruara ne hotel.

Niveli i takses lek per nate fjeteje

Bashkia Dropull	105
Hotele me 4-5yje	
Bujtine,fjetine,motel dhe cdo njesi tjeter akomoduese,sipas percaktimeve te ligjit per turizmin	35

Detyrimi per taksen llogaritet si shumezim I nivelit te takses se vendosur nga bashkia ,per nate qendrimi ,me numrin e neteve te qendrimin ne hotel.

Struktura per vjeljen e takses Drejtoria e te Ardhurave.

4-Taksa ne Infrastruktura nga ndertimet e reja

Baza e takses eshte vlera ne lek e investimit te ri qe kerkohet te kryhet ose vlera ne leke e cmimit te shitjes per meter katror te investimit te ri.

Niveli I takses sipas kategorive si me poshte:

Nr	KATEGORIA/NENKATEGORIA	Koeficienti ne % ndaj vleres se ndertimit
1	Taksa e ndikimit ne Infrastruktura	2
2	Per objekte qe jane ne process legalizimi	0.5

Perjashtohen ngapagesa e kesaj takes investimet e kryera per ndertimin e strukturave akomoduese"Hotel/Resort me pese yje,status special",sipas percaktimit ne legjislacionin e fushes se turizmit dhe qe jane mbajtes ten je marke tregtare te rregjistruar dhe njohur nderkombetarisht"brand name".

Struktura pergjegjese per llogaritjen e kesaj takese eshte Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit ne bashki e cila e percjell informacionin tek Drejtoria e te Ardhurave per vjeljen e takses..

5-Taksa mbi kalimin e se drejtes se pronesis per pasurite e paluajtshme

Baza e takses mbi kalimin e se drejtes se pronesis per ndertesat eshte sipërfaqja e ndertimit pronesia e te cilit transferohet.

Baza e takses per kalimin e se drejtes se pronesis per pasurite e tjera te paluajtshme eshte vlera e shitjes se tyre.

Niveli i takses percaktohet ne perqindje dhe niveli tregues eshte 2%.

Niveli percaktohet ne lek per meter katror te bazes se takses .Sipas kategorive te ndertesave eshte si vijon:

Nr	Kategorite e ndertesave	Niveli I takses
I	Ndertesat banimi	100leke/m ²
II	Ndertesat te tjera per tregti dhe sherbime	300leke/m ²
III	Ndertesat te tjera	200leke/m ²



Menyra e mbledhjes:Kjo takse mblihet nga zyrtarët e rregjistrimit te pasurive te paluajtshme,te cilat ne rolin e agentit te taksave,perfitojne 3% te shumes se arketuar dhe diferenca per llogari te bashkise Dropull jo me vone se data 30 e muajit pasardhes.

6-Taksa e mjeteve te perdorura.

Baza e takses ;lloji i mjetit te transportit rrugor.

Struktura pergjegjese per vjeljen e takses:

Struktura e mbledhjes se kesaj takse eshte Drejtoria Rajonale e Sherbimeve te Transportit Rrugor e cila ne rolin e Agjentit perfiton 5% te shumes dhe 25%i kalojne ne te ardhurat e buxhetit te bashkise.

7- Taksa e Tabeles

Taksa e tabelës zbatohet për të gjitha subjektet, të cilat vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private. Tabelat kategorizohen në:

a) Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtarinë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logoja dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një table identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë.

b) Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.

c) Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose joballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si: tarraca, lozha, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, për të tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.

ç) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.

3. Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësi e vetëqeverisjes vendore.

Nivelet e taksës së tabelës, sipas kategorizimeve jepen në aneksin 7te ligjit 9632 date 31.10.2016 i ndryshuar

Ne keto nivele te aplikohet nje ulje ne masen -20% per cdo lloj table .

II.TARIFAT VENDORE

Mbeshtetur ne Ligjin nr.139/2015"Per vetqeverisjen vendore"neni 35pika 5,bashkite krijojne te ardhura nga tarifat vendore per:sherbimet publike qe ato ofrojne; te drejten e perdorimit te pronave publike vendore;dhenien e licensave,te lejeve,autorizimeve dhe per leshimin e dokumentave te tjera ,per te cilat ato kane autoritet te plote ,me perjashtim te rasteve kur percaktohet ndryshe me ligj.

1-Tarifa e pastrimit dhe largimit te mbeturinave

Tarifes se pastrimit i nenshtrohen te gjitha familjet,personat fizik dhe juridik ,qe banojne dhe ushtrojne veprimtari ekonomike Brenda territorit te Bashkise Dropull.

a-Tarifa e pastrimit per familjaret 1200lek ne vit ne fshatrat qe kryhet sherbimi.

Perjashtohen fshatrat qe nuk kryhet sherbimi .

Vjelja do te behet nga Agjenti Tatimor dhe Drejtoria e te Ardhurave.

b-Tarifa e pastrimit per biznesin e vogel per çdo njesi tregtare si me poshte :

-SHITJE ME PAKICE

(Te gjitha pikat fikse si dyqanet ,barakat qe tregtojne artikuj ushqimore industriale e artikuj te ndryshem, dyqanet e veshjes modes bizhuteri etj.

(njesi ushqimi social, te gjitha restorantet , bar ,kafene,disko,fast-food,kafe internet,etj.)

Zona A: Pikat e shitjes qendra Dervician 10.000leke ne vit.

Zona B: Pikat e shitjes qendra Sofratike, Terihat- Jorgucat-Vrisera-Dogana Kakavie. **5000leke ne vit**

Zona C:Te gjitha dyqanet e fshatrave **2.500 leke ne vit**

-NJESI PRODHIMI

Perfshihen tatimpagues si subjekte fizike qe ushtrojne veprimtari prodhimi perpunimi dhe tregtimi si :perpunim duralumini , metalesh ,druri,guri ,tapicerie,letre kartoni,plasmasi,prodhim tulla,tjegulla,bloqe betoni,te ngjashme me to .

10.000leke ne vit

Prodhim me karakter ushqimor si prodhim buke ,embelsirash,pijesh ,peshku,bulmeti,e artikuj te ndryshem te ngjashem me to.

7.000leke ne vit

-NJESI SHERBIMI

Veprimtari te tilla si :Riparime elektroshtepiake ,radio,frigoriger,lavatriçe, etj Fotokopjimi,salon bukurie,e floktore, autoservis, lavazho, saldime,agjensi transporti, kurse kompjuteri ,agjensi doganore,kembim valute , bilardo,lojra per femije e zyra te ndryshme,hotele.

5.000lek ne vit

-PROFESIONE TE LIRA

Perfshihen si :avokate,mjeke,stomatolog, farmacist, ekonomiste, ekspert kontabel,mesues veteriner, ixhinjer te cilet ushtrojne aktivitet ne njesi fikse.

10.000lek ne vit

-TRASPORT MALLRASH E PASAGJERESH

Perfshihen transporti I mallrave ,pasagjereve me autobuze dhe taksi -

5.000leke ne vit

-AMBULANTE

Perfshihen subjektet qe nuk kane nje vendodhje fikse

Makina vetem ne fshatra qe nuk funksionojne dyqanet e fshatit

5.000leke ne vit

c- TARIFE PASTRIMI PER SUBJEKTIN JURIDIK

- a. 40.000 leke ne vit per ente shtetore
- b. ~~40.000~~ per çdo shoqeri tregtare
- b. 50.000 leke ne vit per çdo shoqeri prodhuese dhe ndertuese.

ç-VIPAT

ALFA-SHA 400.000leke/vit

ELKA-SHA 300.000leke/vit

d- agjensi doganore 5.000lek/vit

Tarifa e pastrimit per biznesin do te vilet nga Drejtoria e te Ardhurave

2-Tarifa sherbimi per familjaret

Perfshihen:

a-tarifa e ndriçimit

kjo tarife do te aplikohet 200lek ne vit per çdo familje

b-tarifa e sherbimit vareza publik

kjo tarife do te aplikohet 100lek ne vit per çdo familje

Keto tarifa do te paguhen ne nje kest Brenda muajit Mars.Agjent Tatimor per vjeljen e tarifave.

3-Tarifa per rregjistrim biznesi

-Rregjistrim biznesi si person juridik 10.000leke

- Rregjistrim biznesi si person fizik 3.000leke

-Rregjistrim ambulant 3000leke

4-Tarifa per transportin

Sipas Udhezimit te Ministrise se Transportit dhe Infrastruktures nr .5627date 18.11.2016"Per percaktimin e kriterëve,rregullave dhe dokumentacionit per leshimin e licensave dhe certifikatave per ushtrimin e veprimtarise ne transportin rugor te udhetareve brenda vendit",aplikojme keto taksa:

-Çertifikate per transport udhetarësh ne linje rrethqytetese,afati 1-5vjet

1500leke/vit

Licence per transport udhetarësh ne linje rrethqytetese,afati 5-vjeçar

20.000leke

Çertifikate per transport malli brenda vendit per llogari te vet,afati 5-vjeçar

100leke/ton kapacitet

Zyra e sherbimeve (transporti) ne Bashki bashkepunon me Drejtorine e te Ardhurave ne evidentimin e mjeteve qe pajisen me leje transporti ne Bashki dhe jane objekt i tarifes.

5-Tarifa per leje parkimi dhe vend qendrim

Per autobuzat 10.000 leke ne vit, per mikrobuzat dhe taksit 5000leke ne vit, furgona dhe kamiona deri ne 3.5tone 2000lek/vit;kamiona mbi 3.5 tone 3000leke **AMBULANTET 15.000lek/vit**

Zyra e sherbimeve (transporti) ne Bashki bashkepunon me Drejtorine e te Ardhurave ne evidentimin e mjeteve qe pajisen me leje transporti ne Bashki dhe jane objekt i tarifes se parkimit.

Tarifa per pyje dhe kullotat

- Ne baze te VKM Nr 632,date 11.6.2009, tabela e tarifave per perdorimin te kullotave dhe livadheve per kullotje jane si me poshte vijon:

- pika a,

- Kullota dimerore per dhene 100 leke/krere
- Kullota dimerore per dhi 100 leke/krere
- Kullota dimerore per te trasha 800 leke/krere
- Kullota verore per dhene 100 leke/krere
- Kullota verore per dhi 80 leke/krere
- Kullota verore per te trasha 800 leke/krere
- Pyja qe kulloten per dhene 50 leke/krere
- Pyje qe kulloten per dhi 100 leke/krere
- Pyje qe kulloten per gjedh 60 leke/krere

Pika b-

Tarifa vjetore te perdorimit te siperfaqes se tokes per ndertime provizore ne fondin kullisor nga fermeret qe mbareshtojne bageti jane si me poshte vijon:

Kullota verore- dimerore –Qender stani e rrethuar 50lek/m2/vite.

Tarifa do te realizohen nga Drejtoria e Administrimit te Ujrave-Pyjeve Livadheve dhe Kullotave

2– Tarifa per qira shfrytezim toke (nxjerje pllaka,gure,mermer),ne baze te VKM Nr1064,date 22.12/2010,lidhja Nr 2,pika 6:

Subjektet qe operojne me aktivitet nxjertje ,prodhim depozitim material inerte (kariere)me dhenien e lejes per shrytezim nga AKBN paraqiten per lidhje kontrate te siperfaqes qe do te shfrytezohet sipas programit vjetor.

- Tarifa per shfrytezim toke (nxjerje pllaka guri,gure,mermer) 540.000 leke/ha per nje vit.

Tarifa do te realizohen nga Drejtoria e Administrimit te Ujrave-Pyjeve Livadheve dhe Kullotave

3– Tarifa per ndertim/perdorim rruge per lidhjen e siperfaqes se dhene ne perdorim ,me rretin rrugor egzistues ne baze te VKM Nr 1064,date 22.12.2010,lidhja Nr 2,pika 12

Tarifa Pyll cungishte 50.000lek/km/vit

4– Tarifa per vendosje antenash ne baze te VKM Nr 1064,date 22.12.2010,lidhja Nr 2,pika 7:

Drejtoria e Administrimit te Ujrave-Pyjeve Livadheve dhe Kullotave ne bashkepunim me Drejtorin e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit informojne Juristin për lidhjen e kontratës dhe Drejtorine e te Adhurave per ndjekjen e arketimit.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse Drejtoria e Administrimit te Ujrave-Pyjeve Livadheve dhe Kullotave

-Tarifa per vendosje te antenave te telefonise te levizshme ne kullota dhe pyje shkure me kohezgjatje kontrate 1 -5 vite 8.500.000 leke/ha.

5- Tarifa dysheme per dhenje ne perdorim me kontrate qiraje te fondit pyjor,kullisor publik per ushtrimin e veprimtarive per mbareshtimin e flores te eger dhe kultivimin e bimeve te ndryshme ne baze te VKM Nr 1064,date 22.12.2010,lidhja Nr 2,tabela 2 eshte si me poshte vijon:

Toke me bimesi pyjore,djerr inprodutive;

-me kohezgjatje 1 vjecare 18.000 leke/ha/vit

-me kohezgjatje 2-5 vjecare 17.250 leke/ha/vit

-me kohezgjatje 6-10 vjecare 12.000 leke/ha/vit

Drejtoria e Administrimit te Ujrave-Pyjeve Livadheve dhe Kullotave eshte pergjegjese per realizimin e ketyre tarifave

6- Tarifa baze te lendes drusore ne kembe ,sipas lidhjeve 1/a dhe 1/b te VKM Nr 1064,date 22.10.2010

Dru zjarri

a-te forta 500 leke/m3

b-te buta 200lek/m3

Drejtoria e Administrimit të Ujrave-Pyjeve Livadheve dhe Kullotave është përgjegjëse për realizimin e këtyre tarifave

7- Tarifa për vaditje nga rezervuarët:

-Tarifa 250 leke /dym për çdo vaditje.

Drejtoria e Administrimit të Ujrave-Pyjeve Livadheve dhe Kullotave është përgjegjëse për realizimin e këtyre tarifave

8-Tarife për pronat fond pyjor kullësor 500lek/ha/vit

Drejtoria e Administrimit të Ujrave-Pyjeve Livadheve dhe Kullotave është përgjegjëse për realizimin e këtyre tarifave.

12-Tarifa që do të aplikohen në fushën e urbanistikës

-Tarife vendore për shqyrtim Leje Zhvillimi 2.000leke familjaret.3000lek bizneset dhe 10000Vipat.

- Tarife vendore për leje ndertimi(Kerkese) 2000lek familjaret.3000lek bizneset dhe 10000Vipat.

- Tarife vendore për leje ndertimi (Vendim) 3.000 leke

- Tarife vendore për leje ndertimi(Perseritje)2.000leke familjaret.3000lek bizneset dhe 10000Vipat.

- Tarife vendore për certifikatën e përdorimit 3.000leke familjaret.5000lek bizneset dhe 10000Vipat.

Deklaratë paraprake nga individë 2000leke bizneset I vogël 3000lek,biznes I madh 3000lek dhe 25000Vipat.

-Tarife vendore për piktet e objektit 2000lek familjaret.5000lek bizneset dhe 10000Vipat

-Tarife vendore e sistemeve të jashtme për leje ndertimi 1000leke familjaret,2500lek bizneset dhe 5000Vipat

Tarife vendore për konfirmim hartash 500leke familjaret,1000lek bizneset dhe 3000Vipat

Tarife vendore për shqyrtim ose nxjerrje dosje 500leke familjaret,1000lek bizneset dhe 2000Vipat

-Tarifa vendore për urbanistikën

Miratim Plan Rivelimi,ZRPP etj 1000lek

Prishje ndertese 100lek

Leje për shpëllëzimin e sipër ndertimi 500lek

Ndryshime në projekt 2.000leke familjaret.3000lek bizneset dhe 10000Vipat.

Vertetim që nuk kërkon pajisje për leje ndertimi 1.000lek

Shtese kati 1.000leke familjaret.2000lek bizneset dhe 2.000Vipat.

Keto tarifa do të ndiqen nga zyra e urbanistikës.

13-Tarife për dhenie me qira truall të lirë

Sipas VKM nr 54. Datë 05.2.2014" Për përcaktimin e kriterëve,procedurës dhe mënyrës së dhenies me qira ,enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"(I ndryshuar)

Niveli I tarifës do të jetë në nivelin dysheme 100leke/m² në muaj

Struktura kompetente për dhenien e dhenie me qira dhe vjeljen e detyrimit që rrjedhin prej tyre është zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, pranë bashkisë.

14-Tarife për dhenie ndertesa me qira

Bazë e tarifës për dhenie ndertesa me qira është sipërfaqja në m² e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi.

Niveli I tarifës do të jetë në nivelin dysheme 50leke/m² në muaj.

15.Tarifa për dhenie license për tregtim karburanti e lende djegëse

Bazuar ne VKM nr .970 date 02.12.2015)"Per percaktimin e procedurave dhe kushteveper dhenien e licensave dhe tregtimin e naftes bruto dhe nenprodukteve te saj" (I ndryshuar me VKM nr.344,date 19.4.2017).

16.Tarifa e sherbimeve qe kryen Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit.

Kjo takse do te aplikohet sipas VKM .nr 285 date 27.06.2002.

Kjo tarife do te vilet nga sektori Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin.

Gjoha për mos shlyerje në afat të detyrimit sipas ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise"(i ndryshuar)

Mos shlyerje të detyrimeve tatimore (taksa, tarifa)

Nr		
	Gjoha për mosshlyerje të detyrimeve tatimore	Për çdo ditë vonesë 0.06 % e vlerës së detyrimit total papaguar
	taksa, tarifa) brenda afatit	(maksimumi 365 ditë)

Tatimpaguesidetyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoha nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike , Ngarkohet Drejtoria përkatëse , për llogaritjen dhe mbledhjen e këtyre tarifave nga personat fizik dhe juridik si dhe institucionet që kanë detyrimin për të paguar.

Ne rast konstatimesh te shkeljeve te ndryshme ligjore do te aplikohen nivelet e gjobave siç i percakton legjislacioni ne fuqi.Keto gjoha do te vendosen nga policia Bashkiake dhe nga drejtorite perkatese sipas natyres se kundravajtjeve .

Për mos zbatim te tarifave te zbatohen saksionet deri ne mos paisje me dokumentacionin perkates nga Bashkia.

III.Ngarkohen Drejtoritë perkatese per zbatimin e ketij vendimi.

IV.Ky vendim hyn ne fuqi sipas percaktimeve te nenit 55,pika 6 te ligjit nr.139/2015"Per VeteqeverisjenVendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefekti I Qarkut Gjirokastër.

KRYETARI I KESHILLIT
DONIKA BAUCI

